



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:261084
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05629255

KPPP.nr.2025/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “ORBICO” Sh.P.K., me adresë Magjistralja Prishtinë-Shkup, Llapnaselo, Prishtinë, me NRB: 70213697, kundër debitorit V.Z. Company Sh.P.K., me adresë në Prishtinë, Tirana p.n., 2524/1, me NUI: 810507410, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.1763/23 të datës 17.10.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datë 25.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit V.Z.Company Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.1763/23 të datës 17.10.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Isa Gacaferi, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr.1763/23 të datës 17.10.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: faturës nr.FSHP22-14196 të datës 05.09.2022, faturës nr.FSHP22-17170 të datës 19.10.2022, dhe faturës nr.FSHP22-16956 të datës 17.10.2022, me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat më sipër, brenda

afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguajë kreditorit shumën prej 6,512.79 Euro, me kamatën referente si pjesë e kamatës ligjore (lartësinë e të cilës BQK e publikon në bazë të rregullt gjashtëmujore sipas Ligjit nr.05/L-110 për Kamatëvonesa në Transaksione Tregtare) duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, për faktin se urdhri ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përbarimore si dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se palët nuk kanë asnjë marrëveshje apo kontratë e cila specifikon se në rast vonesash aplikohet kamatëvonesa. Gjithashtu, debitori ka shtuar se kreditori lëshimin e faturave nuk e ka bazuar në një kontratë apo marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit lidhur me furnizimet e specifikuar në fatura. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, dhe të anulohet në tërësi urdhri përbarimor i Përbaruesit Privat.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se debitori përveç citimeve të thata në prapësim i njejtë nuk e kundërshton urdhrin përbarimor sipas shkaqeve të përcaktuara në LPP, si dhe nuk ka prezantuar asnjë provë me shkrim që ta bind gjykatën ose kreditorin për aludimet e tij në raport me gjendjen faktike që debitori pretendon se është ndryshe. Më tej ka theksuar se dokumentin e besueshëm kreditori ia ka dorëzuar debitorit në mënyrë të rregullt ku është nënshkruar nga zyrtarët e debitorit, dhe mbi këtë bazë Përbaruesi ka lejuar përbarimin. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pathemeltë prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përbarim i Përbaruesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-

së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentet e besueshme faturën nr.FSHP22-14196 të datës 05.09.2022, faturën nr.FSHP22-17170 të datës 19.10.2022, dhe faturën nr.FSHP22-16956 të datës 17.10.2022 në kopje të vërtetuar sipas ligjit dhe me të gjitha elementet përmbajtjesore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, të njëjtat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar sipas ligjit dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula dhe nënshkrimi i debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2025/23, me datë 25.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.